



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



01-235

Në bazë të nenit 21 dhe 44 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008 dhe nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05nr.350/03-34398/19 dt.13.02.2019, të kërkesit, investitorit “**Trio Construction**” sh.p.k. me adresë në rr.”Gazmend Zajmi”, p.nr., në Prishtinë, për miratimin e korigjimit të Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 0194539/18 dt.13.12.2018, të lëshuara nga kjo Drejtori, me anë të cilit janë caktuar kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor – projektit kryesor, për ndërtimin e ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, në kuadër të nëntërësisë “B-1”, blloku urban “b_03”, të Planit Rregullues “Muhaxhirët” dhe PZHU, në Prishtinë, Drejtorja e Urbanizmit në procedurë administrative, me datë 28.02.2019, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE 05 NR.350/02 – 0194539/18 DT.13.12.2018

- I. **Korigjohen** kushtet ndërtimore, të miratuara me Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore 05nr.350/02–0194539/18 dt.13.12.2018 të lëshuara nga Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, sipas kërkesës 05nr.350/03-34398/19 dt.13.02.2019, në emër të pronarëve Nazmi, Shefki, Fitnete, Liridon, Lorik Visoka, Drita Jakupi Visoka, Ilir, Sabri, Ajet, Albulena, Agron Sogojeva nga Prishtina, me investitor “Trio Construction” sh.p.k. Com”, me seli në Prishtinë, me anë të të cilit Vendim, janë caktuar kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor – projektit kryesor, për lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumë banesore dhe afariste, në kuadër të nëntërësisë “B-1”, bllokut urban “b_03”, të Planit Rregullues “Muhaxhirët” dhe PZHU, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr.2759-2 dhe 2759-3 ZK Prishtinë, me trajtim edhe të pjesës së parcelës kadastrale nr.2674-0 ZK Prishtinë (pjesën brenda vijës rregulluese, në pronësi komunale, në këmbim me pjesën e parcelës kadastrale nr.2759-2 ZK Prishtinë, në pronësi private, sipërfaqja jashtë vijës rregulluese).
- II. Korigjimi bëhet në shtojcën grafike të Vendimit 05nr.350/02–0194539/18 dt.13.12.2018, respektivisht në manualin, ku prezentohet ‘**propozimi për këmbim**’ të punuar nga kompania gjeodete e licencuar “Geo-Group” sh.p.k. me licencë nr.52, e cila i bashkangjitet këtij Vendimi.
- III. Me këtë Vendim, korigjohet Vendimi 05nr.350/02–0194539/18 dt.13.12.2018, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, të lëshuar nga Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës dhe i njëjti do të prodhoj efekte juridike nga dita e miratimit të tij.

A r s y e t i m

Investitori “Trio Construction” sh.p.k. me seli në Prishtinë, me certifikatë të biznesit nr. 70583860, dhe përfaqesues/pronar Hasan Guney Demir, me kërkesën 05nr.350/03-34398/19 dt.13.02.2019, ka kërkuar nga Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, miratimin e korigjimit të Vendimit 05nr.350/02–0194539/18 dt.13.12.2018, me të cilin janë përcaktuar kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimorë për lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, sipas përshkrimit dhe lokacionit të përshkruar në pikën I. të dispozivit të këtij Vendimi.

Bashkëngjitur me kërkesë, kërkuesi ka prezantuar:

- Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore 05nr.350/02–0194539/18 dt.13.12.2018, të lëshuar nga kjo Drejtori;
- Manualin ‘*propozimi për këmbim*’ të punuar nga kompania gjeodete e licencuar “Geo-Group” sh.p.k. me licencë nr.52;
- Licencën për kryerjen e matjeve kadastrale nr.52 të kompanisë gjeodete “Geo-Group” sh.p.k.;
- Certifikatë e regjistrimit të kompanisë gjeodete “Geo-Group” sh.p.k me nr.600910419

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të prezantuar, konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi, dokumentet e planifikimit hapësinor për hapësirën, dhe hulumtimin të arkivit të kësaj drejtorie, ka konstatuar se, me Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore 05nr.350/02–0194539/18 dt.13.12.2018, në emër të pronarëve Nazmi, Shefki, Fitnete, Liridon, Lorik Visoka, Drita Jakupi Visoka, Ilir, Sabri, Ajet, Albulena, Agron Sogojeva nga Prishtina, me investitor “Trio Construction” sh.p.k. Com”, me seli në Prishtinë, me anë të të cilit Vendim, janë caktuar kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor – projektit kryesor, për lejimin e ndërtimit të të ndërtesës shumë banesore dhe afariste, në kuadër të nëntërësisë “B-1”, bllokut urban “b_03”, të Planit Rregullues “Muhaxhirët” dhe PZHU, në Prishtinë.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të prezantuar, konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi, dokumenteve të planifikimit hapësinor për hapësirën në fjalë, ka konstatuar se, duhet të bëhet korrigjimi i Vendimit të lartëcekur, përkatësisht ndryshimin e manualit për propozim të këmbimit, të punuar nga kompania gjeodete e licencuar “Geo-Group” sh.p.k. me licencë nr.52, e që konkretisht ka të bëjë me këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr.2674-0 ZK Prishtinë në pronësi komunale -pjesën brenda vijës rregulluese, me pjesën e parcelës kadastrale nr.2759-2 ZK Prishtinë, në pronësi private, sipërfaqja jashtë vijës rregulluese e planifikuar me Planin Rregullues “Muhaxhirët”, për rrugë publike. Ndryshimi në manual ka të bëjë me ndryshimin e formës së sipërfaqes për këmbim të pjesës së parcelës kadastrale 2674-0 ZK Prishtinë në pronësi komunale, ku sipërfaqja e propozuar për këmbim mbetet e njëjtë, por që ky ndryshim ka rrjedhë si pasojë pas vazhdimin të procedurave të këmbimit nga ana e investitorit, në drejtorinë përkatëse, ku një pjesë e sipërfaqes së propozuar për këmbim të parcelës së lartëcekur ka dalë të jetë pronë private pas vërtetimit të pronësisë nga ana në Drejtorinë e Kadastrit, e që ky ndryshim duhet të jetë në tërësi sipas manualit të bashkëngjitur këtij Vendimi si dhe përshkrimin në pikën I. të dispozitivit të këtij Vendimi.

Andaj, bazuar në të thënat e lartshënuara dhe rregullativën ligjore në fuqi, u konstatua se korrigjimi i kërkuar, nuk është në kundërshtim me kriteret e parapara me Planin Rregullues “Muhaxhirët” dhe PZHU, andaj, kjo drejtori, vendosi që i njëjti korrigjim, të miratohet përmes këtij vendimi, sipas përshkrimin në pikën I. të dispozitivit të këtij Vendimi.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Shtojcë: Manuali me ndryshime të ‘*propozimit për këmbim*’, i punuar nga kompania gjeodete e licencuar “Geo-Group” sh.p.k, me licencë nr.52.

Udhëzim Juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dërgohet: Kërkuessve/investitorit, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05nr.350/02–0194539/18 dt.08.08.2018.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,

05 NR. 350/03-34398/19 DT, 28.02.2019

Zyrtare:

Sazan Raskova

U.D. Udhëheqëse e Sektorit:

Lindita Beqiri





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY



Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 02759-2, 02759-3

Zona kadastrale / Katastarska zona: Prishtinë


Numri i lëndës / Broj predmeta: /2018

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 500

Propozim për ndarje dhe bashkim te parcelave

Nr	Y	X
1	7513858.825	4724111.391
2	7513865.476	4724112.292
3	7513873.054	4724118.256
4	7513873.675	4724120.581
5	7513877.900	4724124.980
6	7513882.138	4724142.591



Rilevoi / Snimio: "Geo-Group" Sh.p.k.

(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 52

Nënskrimi / Potpis:

Data e rilevimit / Datum snimanja: 12.02.2019



Aprovoi / Usvojio: _____

(emri dhe mbiemri i përsonit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënskrimi / Potpis: _____

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____

